



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



ОПШТИНА ГРАЧАНИЦА
KOMUNA E GRAÇANICËS
MUNICIPALITY OF GRAÇANICA

Në bazë të nenit 43 dhe nenit 47 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale ("Gazeta zyrtare e RK-së" nr.28/2008), nenit 5 të Udhëzimit administrativ nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të komunës, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës thërret mbledhjen e rregullt dhe dërgon:

FTESË

I nderuar,

Ftoheni që të merrni pjesë në mbledhjen e parë të rregullt të Kuvendit Komunal të Graçanicës, e cila do të mbahet të mërkurën më datën 29.01.2025. Mbledhja do të fillojë në orën 10:30.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit, kati i parë nr. 2.11 në objektin e Komunës së Graçanicës në Graçanicë.

Të bashkëngjitur me ftesë gjeni rendin e ditës dhe materialin për këtë mbledhje. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND I DITËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e nëntë e rregullt, e mbajtur më datën 27.12.2024.
2. Shqyrtimi dhe miratimi Raportit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025, me propozim të kryetares së Komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për ndryshimet e miratuara të personelit dhe shumës përkatëse buxhetore për kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe shtesa në paga", me propozim të drejtorit të buxhetit dhe financave, Sllavisha Niçiq.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Shërbime Publike për vitin 2024, me propozim të Komitetit për Shërbime Publike.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024, me propozim të kryesuesit të Komitetit për Komunitete, Aziz Karadollami.
7. Të ndryshme.

Me respekt,

Kryesuesi i KK të Graçanicës
Milan Dimitrijević

